



Lezhë Buxheti
i
Qytetarit

Rezultatet dhe analiza e pyetësorëve

“Buxheti i Qytetarit: Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje aktive në Bashkinë Lezhë”

Ky raport është hartuar nga Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje si pjesë e nismës “**LëvizAlbania** – Demokracia Vendore në Veprim”, falë mbështetjes financiare të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri.

Ky botim u realizua me mbështetjen e LëvizAlbania. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e LëvizAlbania.

Autorët:

Prof. Dr. Arben Malaj

Dr. Ledjon Shahini

Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij raporti duhet të bëhen pranë zyrave të Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisje ose pranë zyrave të LëvizAlbania, në adresat:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

Rr. e Elbasanit Nr.8,

Tiranë, Shqipëri

E-Mail: secretary@ippm.al

LëvizAlbania

Rr. Bardhok Biba Godina 12 kate - Mbrapa Hotel Tiranes

Nd. Trema, Hyrja B, Kati 9, Ap. 25

Tiranë, Shqipëri

E-Mail: info@levizalbania.al

Përmbajtja

1. Hyrje	6
2. Objektivat dhe qëllimi.....	6
3. Vështrim i përgjithshëm.....	6
4. Metodologjia e përdorur	7
4.1. Përcaktimi dhe madhësia e kampionit	7
5. Rezultatet dhe analiza e pyetësorëve	8
5.1. Të dhëna mbi të anketuarit (Seksioni 1)	8
5.2. Vlerësimi mbi cilësinë e jetesës, investimet dhe shërbimet (Seksioni 1)	9
5.3. Perceptimi i qytetarëve mbi buxhetin (Seksioni 2).....	11
5.4. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e buxhetimit (Seksioni 3)	13
5.5. Komete (Seksioni 4)	15
6. Përmbledhje	15
Aneks 1	17

Lista e tabelave

Tabela 1. Cilësia e jetës, investimet dhe shërbimet	9
Tabela 2. Informimi i qytetarëve	11
Tabela 3. Realizimi efektiv, transparenca dhe vlera e shtuar nga qytetarët.....	14
Tabela 4. Vlerësimi sipas fushave specifike ku bashkia mund të ndërhyjë.....	15

Lista e figurave

Figura 1. Buxheti i Qytetarit: Bashkia Lezhë	6
Figura 4. Të anketuarit sipas gjinisë	8
Figura 5. Të anketuarit sipas nivelit të arsimimit	8
Figura 3. Të anketuarit sipas moshës	8
Figura 2. Të anketuarit sipas grupit	8
Tabela 1. Cilësia e jetës, investimet dhe shërbimet	9
Figura 6. Cilësia e përgjithshme e jetës	9

Figura 7. Niveli i mjaftueshëm i investimeve.....	9
Figura 8. Shërbimet e përgjithshme të qytetit.....	9
Figura 9. Vlerësimi i cilësisë së jetës sipas gjinisë së të anketuarve	10
Figura 10. Vlerësimi i shërbimeve të përgjithshme të qytetit sipas gjinisë së të anketuarve	10
Figura 11. Njohuritë mbi fazat e procesit të buxhetit sipas gjinisë së të anketuarve.....	11
Figura 12. Njohuritë mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Lezhë.....	11
Figura 13. Takime me përfaqësues të bashkisë në lidhje me realizimin e buxhetit.....	12
Figura 14. Niveli i informimit mbi konsultimet që bën bashkia për buxhetin.....	12
Figura 16. Perceptimi mbi keqpërdorimin e buxhetit nga zyrtarët e qeverisë	13
Figura 15. Niveli i transparencës së procesit të realizimit të buxhetit	13
Figura 18. Pjesëmarrja në seanca dëgjimore në lidhje me realizimin e buxhetit.....	13
Figura 17. Dëshira për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit të rrethit.....	13
Tabela 3. Realizimi efektiv, transparenca dhe vlera e shtuar nga qytetarët.....	14
Tabela 4. Vlerësimi sipas fushave specifike ku bashkia mund të ndërhyjë.....	15

1. Hyrje

Buxheti vjetor është instrumenti kryesor me të cilin qeveria përkthen politikat e saj në veprim. Për këtë arsye buxheti jo vetëm duhet të jetë i disponueshëm për publikun, por duhet të jetë gjithashtu i aksesueshëm dhe i hapur gjatë fazave të hartimit apo implementimit të tij. Ndonëse është thelbësore që qeveritë të jenë proaktive në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi buxhetin, buxheti vjetor është shpesh i gjatë, kompleks, dhe i shoqëruar nga shumë dokumenta mbështetëse të detajuara, çka e bën atë edhe më të vështirë për tu kuptuar nga publiku. Buxheti i qytetarit është një instrument që ndihmon në këtë drejtim; ai është një përmbledhje e thjeshtëzuar e buxhetit, e hartuar në gjuhë jo teknike me qëllim për të qenë më i aksesueshëm nga një audiencë e gjerë.


Që të ndërtohen politika sa më të mira dhe gjithëpërfshirëse është shumë e rëndësishme të kihen disa tregues të matshëm mbi njohuritë që kanë qytetarët mbi buxhetin dhe perceptimin që kanë ata në mënyrën e përfshirjes së tyre në procesin e planifikimit dhe implementimit të tij. Në këtë kuadër ky studim synon të nxjerrë disa konkluzione konkrete mbi perceptimin e qytetarëve të Lezhës për buxhetin e bashkisë mbështetur mbi analizat e dala nga të dhënat e mbledhura me anë të anketimit.

2. Objektivat dhe qëllimi

Pyetësorët e zhvilluar nga IPPM dhe të analizuar në këtë raport kanë si qëllim vlerësimin e nivelit të të kuptuarit të buxhetit vendor dhe të pjesëmarrjes në proceset e hartimit të buxhetit nga ana e qytetarëve të Bashkisë Lezhë. Rezultatet e arritura në këtë raport do të përfshihen gjithashtu në raportin final të projektit për të bërë një analizë përmblylëse të perceptimit të qytetarëve mbi elementët e buxhetit të Bashkisë Lezhë dhe fazat e hartimit të tij, dhe të ndikimit që projekti “Buxheti i Qytetarit: Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje aktive në Bashkinë Lezhë” ka pasur në këtë drejtim.

3. Vështrim i përgjithshëm

Figura 1. Buxheti i Qytetarit: Bashkia Lezhë



Projekti “Buxheti i Qytetarit: Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje aktive në Bashkinë Lezhë” synon të sensibilizojë qytetarët e Lezhës mbi rëndësinë që kanë për zhvillimin vendor politikave të përgjegjshme buxhetore vendore dhe t’i aftësojë qytetarët që të monitorojnë realizimin e buxhetit në Bashkinë Lezhë dhe të mund të advokojnë të drejtat qytetare për qeverisje buxhetore të përgjegjshme në nivel vendor.

Gjatë muajve dhjetor dhe janar IPPM realizoi plotësimin e pyetësorëve (Aneks 1) nga ana e katër grupeve kryesore të interesit (të rinjtë, shoqëria civile, biznesi dhe

media) në Bashkinë Lezhë. Pyetëtori përmban 34 pyetje të karakterit cilësor dhe përfshinin në përmblyllje një hapësirë për komente individuale të ndryshme nga ana e të anketuarve. Në total IPPM realizoi 340 pyetësorë, nga të cilët nxënës/studentë të anketuar ishin 260, përfaqësues të shoqërisë civile ishin 32, përfaqësues të komunitetit të medias ishin 15, përfaqësues të komunitetit të biznesit ishin 12 dhe individë të tjerë që nuk bënë pjesë në këto kategori ishin 21 persona. Rezultatet e këtyre pyetësorëve përmbliidhen dhe analizohen më poshtë në mënyrë më të hollësishme.

4. Metodologjia e përdorur

Pyetëtori i analizuar në këtë raport u përgatit nga ekspertë të IPPM me qëllim matjen e perceptimit të qytetarëve mbi buxhetin e Bashkisë Lezhë. Gjatë muajve dhjetor dhe janar pyetëtori ju shpërnda një kampioni përfaqësues prej 340 personash në Bashkinë Lezhë, përmes metodës së vrojtimit ballë për ballë, ku secilit prej tyre ju dha mundësia e plotësimit me shkrim të pyetësorit në mënyrë të pavarur.

Pyetëtori përbëhej nga katër seksione. Seksioni i parë përmbante pyetje të përgjithshme të cilat synonin të mblidhnin të dhëna bazë mbi të anketuarit (si psh. grupi të cilit i përkisnin, mosha, gjinia dhe niveli i edukimit) si dhe disa vlerësime të përgjithshme nga ana e të anketuarve mbi standartin e jetesës, investimet publike dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia Lezhë.

Seksioni i dytë fokusohet në perceptimin e qytetarëve mbi buxhetin përmes tre nën-seksioneve: niveli i njohjes së buxhetit, niveli i të kuptuarit të buxhetit, dhe perceptimi i qytetarëve mbi buxhetin vendor. Përmes pyetjeve specifike, të anketuarit kishin mundësinë të reflektonin sa familjarë ata ishin me aspektet e ndryshme të buxhetit, duke nisur nga hartimi e deri tek implementimi i tij.

Seksioni i tretë vinte fokusin në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e buxhetimit. Në këtë seksion të anketuarit mund të zgjidhnin gjithashtu mes një serë rekomandimesh dhe vlerësimesh mbi cilat janë mënyrat më efikase për realizimin e buxhetit, rritjen e transparencës së tij si dhe përfshirjen e qytetarëve.

Seksioni i fundit përmbante një pyetje të hapur ku të anketuarit kishin mundësinë që të shprehnin komente të ndryshme mbi buxhetin e Bashkisë Lezhë në mënyrë që të mbulonin dhe aspekte të tjera të tij jo të përfshira në tre seksionet e mëparshme të këtij pyetësori.

Pyetëtori përmbante në total 34 pyetje të mbyllura (të tipit po/jo, me zgjedhje të shumëfishtë, apo me renditje për të matur rëndësinë relative të përgjigjes) dhe një pyetje të hapur.

4.1. Përcaktimi dhe madhësia e kampionit

Studimi përmban një vrojtimit të katër grupeve kryesore të interesit në Bashkinë Lezhë: rinia, media, bizneset dhe shoqëria civile. Për të kontrolluar gabimet e mbulimit, kampioni mbuloi njësi të ndryshme administrative të Bashkisë Lezhë dhe ekspertët e IPPM u siguruan që pyetësorët të zhvilloheshin në zona ku niveli i informimit mbi buxhetin vendor të ishte i

rastësishëm. Një individ u cilësua si i kualifikuar për të qenë pjesë e këtij vrojtimi nëse ishte; (i) Banues në Bashkinë Lezhë, (ii) 16 vjeç e lart.

Referuar katër grupeve të interesit një numër me 340 të anketuar ka një mbulim të kënaqshëm statistikor. Për të ruajtur peshat statistikore pjesa më e madhe e të anketuarve u bë te grupi i të rinjve të cilët përbëjnë dhe numrin më të madh në të katër grupet e interesit. Në dy nga grupet, atë të shoqërisë civile dhe medias, mbulimi që në nivele shumë të larta. Pavarësisht numrit të vogël të këtyre dy grupeve, për të arritur në konkluzione sa më të mira mbulimi i tyre u bë në nivele mbi 80 % të totalit.

5. Rezultatet dhe analiza e pyetësorëve

5.1. Të dhëna mbi të anketuarit (Seksioni 1)

Përqindja më e lartë e të anketuarve përbëhej nga nxënës dhe studentë, me rreth 76.5% të numrin total të të anketuarve, i ndjekur nga shoqëria civile me rreth 9% të të anketuarve, bizneset me rreth 5% dhe media me rreth 4%. Numri i lartë i të anketuarve me status nxënës apo studentë reflektohet dhe në grupimin e të anketuarve sipas moshës dhe nivelit të edukimit, ku përqindjen më të lartë e zë moshën deri në 24 vjeç (77%) dhe niveli i edukimit të mesëm (rreth 78%). Moshat 25-44 si dhe 45-64 zënë secila 11% të numrit total të të anketuarve, ndërsa vetëm 1% e tyre janë mbi 65 vjeç.

Figura 2. Të anketuarit sipas grupit




Figura 3. Të anketuarit sipas moshës




Figura 4. Të anketuarit sipas gjinisë





Figura 5. Të anketuarit sipas nivelit të arsimit



Përsa i përket shkollimit, rreth 13% e të anketuarve kanë ndjekur apo po ndjekin arsimin e lartë, ndërsa përqindja e të anketuarve me arsimim fillor apo doktoraturë është mjaft e ulët, me 0.3% për secilin nga këto dy grupime. Ndërsa përsa i përket gjinisë së të anketuarve, grupi është mjaft i balancuar, me 53% femra dhe 47% meshkuj, një përqindje e cila na lejon të analizojmë rezultatet e këtij pyetësi nga një këndvështrim i drejtë gjinor.

5.2. Vlerësimi mbi cilësinë e jetesës, investimet dhe shërbimet (Seksioni 1)

Numri dhe përqindja më e lartë e të anketuarve e vlerësojnë cilësinë e përgjithshme të jetesës në rrethin e tyre si mesatare (Fig.6). Ndërkohë, përqindja e të anketuarve që e cilësojnë cilësinë e jetesës në rrethin e Lezhës si të shkëlqyer apo të mirë (30.9%) është më e lartë se ajo e atyre që e konsiderojnë si të varfër apo shumë të varfër (18.5%).

Tabela 1. Cilësia e jetës, investimet dhe shërbimet

Pyetja 1.5. Si do ta vlerësonit cilësinë e përgjithshme të jetës në rrethin tuaj?		
	Numri i të anketuarve	Përqindja (%)
Të shkëlqyer	21	6.2
Mirë	84	24.7
Mesatare	172	50.6
Të varfër	52	15.3
Shumë të varfër	11	3.2
Pyetja 1.6. Mendoni se ka mjaftueshëm investime në rrethin tuaj krahasuar me taksat që paguani?		
Bie dakort plotësisht	10	2.9
Bie dakort	63	18.5
Asnjë	94	27.7
Nuk bie dakort	127	37.4
Aspak dakort	46	13.5
Pyetja 1.7. Sa jeni të kënaqur me shërbimet e përgjithshme të qytetit?		
Shumë të kënaqur	14	4.1
Të kënaqur	130	38.2
Asnjë	90	26.5
Të pakënaqur	88	25.9
Shumë të pakënaqur	18	5.3

Figura 6. Cilësia e përgjithshme e jetës




Figura 7. Niveli i mjaftueshëm i investimeve





Figura 8. Shërbimet e përgjithshme të qytetit



Përsa i përket investimeve (Fig.7), pjesa më e madhe e të anketuarve nuk bie dakort se ka mjaftueshëm investime në rrethin Lezhë krahasuar me taksat e paguara (37.4%), ndërsa grupimi i dytë me i madh është asnjans ndaj kësaj pyetje. Mbi vlerësimin e shërbimeve të përgjithshme të qytetit (Fig.8), përqindja më e lartë e qytetarëve janë të kënaqur (38.2%), ndërsa përqindja e të anketuarve të pakënaqur dhe asnjans është pothuajse e njëjtë.

Një fakt tjetër që vihet re nga kryqëzimi i rezultateve të pyetjeve 1.3 (gjinia) dhe 1.5 (vlerësimi mbi cilësinë e jetës), është se ka një pakënaqesi më të lartë nga ana e meshkujve krahasuar me femrat përsa i përket cilësisë së përgjithshme të jetës në rrethin e Lezhës (Fig. 9). Ndërkohë që rreth 30% e femrave janë përgjigjur se cilësia e jetës është e mirë, vetëm rreth 18% e meshkujve kanë dhënë të njëjtën përgjigje. Kjo diferencë mes dy gjinive reflektohet gjithashtu nga kryqëzimi i pyetjeve 1.3 (gjinia) dhe 1.7 (vlerësimi i shërbimeve të përgjithshme të qytetit), ku duket se vlerësimi është më pozitiv nga ana e femrave krahasuar me meshkujt e anketuar (Fig.10).

Figura 9. Vlerësimi i cilësisë së jetës sipas gjinisë së të anketuarve





Figura 10. Vlerësimi i shërbimeve të përgjithshme të qytetit sipas gjinisë së të anketuarve




5.3. Perceptimi i qytetarëve mbi buxhetin (Seksioni 2)

Rezultatet e pyetësorëve në pjesën e matjes së perceptimit të qytetarëve të Bashkisë Lezhë mbi buxhetin tregojnë se informimi nga ana e qytetarëve është i ulët. Tab. 2. përmbledh disa nga të dhënat. Përsa i përket perceptimit qytetar sipas gjinisë, kryqëzimi i pyetjes 1.3 (gjinia) me atë 2.2.3 (sa njohuri keni mbi fazat e procesit të buxhetit) tregon sërish se femrat kanë një perceptim më të ulët krahasuar me meshkujt (Fig.11).

Tabela 1. Informimi i qytetarëve


82%	E të anketuarve nuk i kanë parë ndonjëherë pasqyrat financiare të buxhetit të Bashkisë Lezhë.
77%	E të anketuarve nuk kanë takuar ndonjëherë përfaqësues të Bashkisë Lezhë në lidhje me realizimin e buxhetit.
83%	E të anketuarve janë <i>aspak</i> ose <i>pak</i> të informuar mbi konsultimet që bën bashkia mbi buxhetin.
84%	E të anketuarve kanë <i>aspak</i> ose <i>pak</i> kanë njohuri mbi fazat e procesit të buxhetit.
76%	E të anketuarve janë <i>aspak</i> ose <i>pak</i> në dijeni mbi bazën ligjore të buxhetit vendor.
73%	E të anketuarve që i përkisnin grupit <u>nxënës/student</u> janë <i>aspak</i> ose <i>pak</i> në dijeni mbi fondet e shpërndara në shkollat publike në zonat e tyre.
59%	E të anketuarve mund të bënin <i>aspak</i> ose <i>pak</i> dallimin midis buxhetit plan dhe atij faktik.
81%	E të anketuarve janë <i>aspak</i> ose <i>pak</i> në dijeni në lidhje me fondet e shpërndara në spitalet publike në zonën e tyre.

Figura 11. Njohuritë mbi fazat e procesit të buxhetit sipas gjinisë së të anketuarve



Përsa i përket informimit dhe pjesëmarrjes sipas grupeve të ndryshme të interesit, grupet më pak të informuara rezultojnë të jenë nxënësit/studentët dhe shoqëria civile, sic dhe shihet nga

Figura 12. Njohuritë mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Lezhë




rezultatet e pyetjeve 2.1.1 (Fig. 12) dhe 2.1.3 (Fig. 13) në grafikët e mëposhtëm. Përfaqësuesit e bizneseve rezultojnë të jenë grupimi më aktiv, i cili ka kryer më shumë takime me përfaqësues të bashkisë në lidhje me realizimin e buxhetit. Ndërkohë, 61% e të anketuarve u përgjigjën se nuk janë në dijeni të ndonjë projekt zhvillimi të ri që ka nisur në zonën e tyre këtë vit.

Nga ana tjetër, 88.5% e të anketuarve bien dakort se qytetarët duhet të kenë një rol në procesin e realizimit të buxhetit (pyetja 2.1.2) dhe 93% e tyre mendojnë se buxheti duhet të jetë më i arritshëm dhe më i lehtë për tu kuptuar për publikun e gjerë (pyetja 2.1.5).

Përsa i përket informimit mbi konsultimet që bën bashkia me grupet e ndryshme të interesit

Figura 13. Takime me përfaqësues të bashkisë në lidhje me realizimin e buxhetit




(pyetja 2.2.1), media edhe njëherë rezultoi të jetë grupimi më i informuar, ndërsa nxënësit/studentët ata më pak të informuar (Fig.14).

77% e të anketuarve bien dakort se njerëzit e thjeshtë duhet të kenë njohuri në lidhje me buxhetin e bashkisë së tyre (pyetja 2.3.1) dhe rreth 70% e tyre mendojnë se buxheti ka një ndikim shumë të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve (pyetja 2.3.8). Këto të dhëna forcohen edhe më tej nga rezultatet që tregojnë se ka një informim të ulët nga ana e qytetarëve. Në fakt, rreth 75% e të anketuarve kanë *aspak* ose *pak* informacion mbi vlerën që

ka buxheti i bashkisë së Lezhës në të ardhura dhe shpenzime (pyetja 2.3.2) si dhe rreth 80% e tyre nuk kanë marrë ndonjëherë informacion për ndonjë konsultim nga bashkia për buxhetin (pyetja 2.3.7).

Figura 14. Niveli i informimit mbi konsultimet që bën bashkia për buxhetin



Nga ana tjetër, të anketuarit treguan një nivel të ulët besimi në transparencën e procesit të realizimit të buxhetit (pyetja 2.3.3) dhe të përdorimit të tij nga ana e zyrtarëve të qeverisë (pyetja 2.3.9). Këtë rezultate, ilustrohen dhe në grafikët e mëposhtëm (Fig.15 dhe Fig.16).

Për më tepër, vetëm 9% e të anketuarve janë përgjigjur se janë *shumë dakort* me faktin që buxheti është realizuar duke mbajtur parasysh problemet dhe kërkesat e zonës së tyre (pyetja 2.3.4), vetëm rreth 10% e tyre shprehen se kanë ndjerë *shumë zhvillim* në zonën e tyre pas

realizimit të buxhetit (pyetja 2.3.5), dhe vetëm rreth 11% e tyre janë shumë dakort se sektori social (arsimi, shëndetësia, furnizimi me ujë etj.) ka një *shpërndarje të mjaftueshme* në buxhetin e rrethit të tyre (pyetja 2.3.6).

Figura 15. Niveli i transparencës së procesit të realizimit të buxhetit





Figura 16. Perceptimi mbi keqpërdorimin e buxhetit nga zyrtarët e qeverisë



5.4. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e buxhetimit (Seksioni 3)

Në bazë të përgjigjeve të të anketuarve, megjithëse perceptimi i qytetarëve mbi buxhetin është i ulët, ka një interes të konsiderueshëm nga ana e tyre që të bëhen pjesë e procesit të buxhetimit në rrethin e tyre. Rreth 86% e të anketuarve, ose 293 prej tyre janë përgjigjur se, nëse do t'u jepej mundësia, do të merrnin pjesë në procesin e buxhetimit të rrethit Lezhë (Fig.3.1). Ndërkohë pothuajse e njejta përqindje/numër i të anketuarve u përgjigjën se nuk kanë marrë asnjëherë pjesë në seanca dëgjimore në lidhje me realizimin e buxhetit (Fig.3.2).

Figura 17. Dëshira për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit të rrethit





Figura 18. Pjesëmarrja në seanca dëgjimore në lidhje me realizimin e buxhetit



Në seksionin numër 3 të pyetësorit ishin gjithashtu të përfshira disa pyetje në formën e alternativave për të marrë disa rekomandime nga ana e të anketuarve për një realizim efektiv të buxhetit, një proces transparent të realizimit të tij dhe për mënyrat se si mund të shtohet vlerë në këtë proces. Sipas përgjigjeve të dhëna (Tab.3), hapat kryesore që duhet të ndërmerren nga bashkia për realizimin efektiv të buxhetit janë (pyetja.3.2):

1. Të bëjnë të kuptueshëm për publikun përmbledhjen e buxhetit;
2. Mbledhje të hapura;
3. Thirrje për propozime nga qytetarët.

Përsa i përket mënyrave që bashkia mund të bëjë procesin e realizimit të buxhetit më transparent, te anketuarit evidentuan tre mënyrat e mëposhtme (pyetja 3.4):

1. Pjesëmarrja e publikut;
2. Vendosja e buxheteve në faqet web të tyre;
3. Lejimi i qasjes në dokumentet buxhetore.

Së fundmi, përsa i përket mënyrës sesi qytetarët mund të shtojnë vlerë në procesin e realizimit të buxhetit të qytetit, të anketuarit identifikuan mënyrat e mëposhtme (pyetja 3.5):

1. Duke identifikuar burimet e financimit që kërkohen për të bërë ndryshim në zonat e tyre;
2. Duke identifikuar shërbimet publike në të cilat fondet janë shpërndarë më pak nga sa kërkohet;
3. Duke identifikuar potencialin e zhvillimit në zonat e tyre;
4. Duke identifikuar fushat prioritare të zhvillimit ekonomik-social të Bashkisë;
5. Duke dhënë mendim mbi prioritetet e shpenzimeve të qeverisë.

Tabela 2. Realizimi efektiv, transparenca dhe vlera e shtuar nga qytetarët

Pyetja 3.2. Cfarë hapash duhet të ndërmerren nga Bashkia për një realizim efektiv të buxhetit?			
	Numri i të anketuarve	Përqindja (%)	Renditja
Mbledhje të hapura	54	15.88	3
Thirrje për propozime nga qytetarët	70	20.59	2
Të bejnë të kuptueshëm për publikun përmbledhjen e buxhetit	54	15.88	3
Tre të mësipërmet	162	47.65	1
Pjesëmarrja e publikut	121	35.59	2
Vendosja e buxheteve në faqet web të tyre	69	20.29	3
Lejimi i qasjes në dokumentet buxhetore	13	3.82	4
Tre të mësipërmet	137	40.3	1
Pyetja 3.5. Si munden qytetarët të shtojnë vlerë në procesin e realizimit të buxhetit të rrethit?			
Duke identifikuar shërbimet publike në të cilat fondet janë shpërndarë më pak nga sa kërkohet;	57	16.76	3
Duke identifikuar fushat prioritare të zhvillimit ekonomik-social të Bashkisë	44	12.94	5
Duke identifikuar burimet e financimit që kërkohen për të bërë ndryshim në zonat e tyre	58	17.06	2
Duke dhënë mendim mbi prioritetet e shpenzimeve të qeverisë	40	11.76	6
Duke identifikuar potencialin e zhvillimit në zonat e tyre	56	16.47	4
Pesë të mësipërmet	85	25.01	1

Në fund, të anketuarit vlerësuan shërbimet sipas fushave specifike ku bashkia mund të ndërhyjë (pyetja 3.6).

Tabela 3. Vlerësimi sipas fushave specifike ku bashkia mund të ndërhyjë

Pyetja 3.6. Si do ti konsideronit shërbimet e Bashkisë në lidhje me secilën nga fushat e mëposhtme?			
Fushat	Shërbim shumë i dobët ose i dobët	Shërbim neutral	Shërbim i mirë ose i shkëlqyer
Arsimimi	24.1 %	31.2 %	44.7 %
Shëndetësia	40.6 %	33.0 %	26.4 %
Ligji dhe Rendi	25.0 %	40.2 %	34.8 %
Infrastruktura Rrugore	50.3 %	27.4 %	22.3 %
Transporti Publik	48.3 %	33.2 %	18.5 %
Furnizim me energji elektrike	43.0 %	29.9 %	27.1 %
Furnizim me ujë	42.6 %	30.1 %	27.3 %
Planifikimi urban dhe strehimi	54.4 %	31.5 %	14.1 %
Kujdesi social	42.6 %	35.6 %	21.8 %
Turizmi	25.0 %	31.5 %	43.2 %
Mjedisi	37.9 %	32.1 %	30.0 %
Pastrimi i qytetit	42.6 %	26.2 %	31.2 %
Kultura dhe sporti	38.8 %	29.8 %	31.4 %

Sic dhe evidentohet nga rezultatet në tabelën e mësipërme, fushat më problematike janë Planifikimi Urban dhe Strehimi, Infrastruktura Rrugore dhe Transporti Publik. Nga ana tjetër, fushat me rezultate më positive sipas gjykimit të të anketuarve janë Arsimimi, Turizmi dhe Ligji dhe Rendi.

5.5. Komente (Seksioni 4)

Në pjesën e tij të fundit pyetësi përmbante një hapësirë për komente për secilin nga të anketuarit. Në bazë të përmbledhjes së këtyre komenteve, pikat që evidentohen më shpesh nga të anketuarit janë:

- Bashkia duhet të bëjë proceset e hartimit të buxhetit më transparente;
- Duhet investuar në edukimin e qytetarëve mbi buxhetin vendor;
- Ka një shpërdorim të buxhetit nga ana e qeverisë vendore;
- Buxheti duhet të fokusohet në investimet infrastrukturore dhe arsimin;
- Mungojnë aktivitetet sportive dhe kulturore në Bashkinë Lezhë dhe buxheti i alokuar për këto aktivitete është i ulët.

6. Përmbledhje

Pyetësorët e zhvilluar nga IPPM me qytetarët e Bashkisë Lezhë pasqyruan një sërë problematikash në lidhje me buxhetin vendor dhe përforcuan bindjen se, ndonëse me luhatje të vogla midis grupeve të ndryshme të interesit apo gjinisë, ekziston një informim dhe pjesëmarrje e ulët e qytetarëve në proceset e hartimit dhe implementimit të buxhetit vendor.

Përgjigjet e grupit më të madh të të anketuarve, i përbërë nga nxënës dhe studentë të Bashkisë Lezhë, vunë në dukje se ka një mangësi në edukimin e brezave të rinj mbi proceset buxhetore në nivel vendor. Kjo mangësi parashikohet që të reflektohet dhe në një nivel të ulët të kërkesës për llogaridhënie kundrejt Bashkisë Lezhë në vitet e ardhshme.

Gjithsesi, përpos evidentimit të rezultateve problematike nga ky pyetësor, duhet vënë në dukje se ka një interesim nga përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të interesit për një përfshirje më të gjerë në proceset në të cilat kalon buxheti i Bashkisë Lezhë.

IPPM synon që aktivitetet e ardhshme të fokusojë në mangësitë që u evidentuan në këtë raport dhe të ndihmojë në një informim dhe përfshirje sa më të gjerë të qytetarëve, në bashkëpunim me strukturat e Bashkisë Lezhë.

Aneks 1

Pyetësor

Mbi perceptimin e qytetarëve për buxhetin e Bashkisë së Lezhës

Objektivi i këtij pyetësori është që të vlerësojë nivelin e të kuptuarit të buxhetit nga grupe të ndryshme qytetarësh të Bashkisë së Lezhës. Pyetësori ka në total 35 pyetje të karakterit cilësor. Për të pasur një përfaqësim sa më të plotë pyetësori do të mbulojë katër grupe interesi: Nxënësit/Studentët, Shoqërinë Civile, Median dhe Komunitetin e biznesit.

Seksioni I: Pyetje të përgjithshme

1.1 Grupi të cilit i përkisni

- Nxënës/ Student
- Përfaqësues të Shoqërisë Civile
- Përfaqësues të Medias
- Përfaqësues të Komunitetit të Biznesit
- Tjetër, Specifiko _____

1.2 Moshë

- deri në 24
- 25-44
- 45-64
- 65 +

1.3 Gjinia

- Femër
- Mashkull

1.4 Niveli i edukimit

- Fillor
- I Mesëm
- I Lartë
- Master
- Doktoraturë

1.5 Si do ta vlerësonit standardin e jetesës në rrethin tuaj?

- Të shkëlqyer
- Mirë
- Mesatare
- Të varfër
- Shumë të varfër

1.6 Mendoni se ka mjaftueshëm investime publike në rrethin tuaj krahasuar me taksat që paguani?

- Bie dakord plotësisht
- Bie dakord
- Asnjëherë
- Nuk bie dakord
- Aspak dakord

1.7 Sa të kënaqur jeni me shërbimet e ofruara nga Bashkia Lezhë?

- Shumë të kënaqur
- Të kënaqur
- Asnjëherë
- Të pakënaqur
- Shumë të pakënaqur

Sekcioni 3: Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e buxhetimit

Shënoni me X, në kutinë përkatëse

3.1 Nëse ju jepet një mundësi, do të donit të merrnit pjesë në procesin e hartimit të buxhetit të Bashkisë tuaj?

Po Jo

3.2 Çfarë hapash duhet të ndërmerren nga bashkia për një realizim efektiv të buxhetit?

- Mbledhje të hapura
- Thirrje për propozime nga qytetarët
- Të bëjnë të kuptueshëm për publikun përmbledhjen e buxhetit
- Tre të mësipërmet

3.3 A keni marrë pjesë në seanca dëgjimore në lidhje me realizimin e buxhetit?

Po Jo

3.4 Si mund ta bëjë më transparent bashkia procesin e realizimit të buxhetit?

- Pjesëmarrja e publikut
- Vendosja e buxhetit në faqet web të tyre
- Lejimi i qasjes në dokumentet buxhetore
- Tre të mësipërmet

3.5 Si mundën qytetarët të shtojnë vlerë në procesin e realizimit të buxhetit të rrethit?

- Duke identifikuar shërbimet publike në të cilat fondet janë shpërndarë më pak nga sa kërkohet
- Duke identifikuar fushat prioritare e zhvillimit ekonomik-social të Bashkisë
- Duke identifikuar burimet e financimit që kërkohen për të bërë ndryshim në zonat e tyre
- Duke dhënë mendim mbi prioritetet e shpenzimeve të qeverisë
- Duke identifikuar potencialin e zhvillimit në zonën e tyre

3.6 Si do t'i konsideronit shërbimet e Bashkisë në lidhje me secilën nga fushat e mëposhtme.

Shëno me X, nivelin që mendoni.

Nr	Fushat	Shërbim shumë i dobët	Shërbim i dobët	Neutral	Shërbim i mirë	Shërbim i shkëlqyer
1	Arsimimi					
2	Shëndetësia					
3	Ligji dhe Rendi					
4	Infrastruktura Rrugore					
5	Transporti Publik					

6	Furnizim me energji elektrike					
7	Furnizim me ujë					
8	Planifikimi Urban dhe Strehimi					
9	Kujdesi Social					
10	Turizmi					
11	Mjedisi					
12	Pastrimi i qytetit					
13	Kultura dhe Sporti					

Dëshironit të shtoni ndonjë gjë tjetër në lidhje me buxhetin e Bashkisë së Lezhës apo shërbimet e përgjithshme që ajo ofron?

Faleminderit për përgjigjet tuaja!

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

Rr. e Elbasanit Nr.8,

Tirana, Albania

E-Mail: secretary@ippm.al